


PLANI RREGULLUES ' QENDRA 2', PRISHTINË PROPOZIMI




PËRMBAJTJA

PJESA TEKSTUALE

1.0 VIZIONI	3
• Synimet specifike të projektit	
• Mjetet gjatë hulumtimit në terren	
2.0 "QENDRA 2"- SIPAS PLANIT STRATEGJIK	8
• Planzhvillimi hapësinor	
• Dendësia urbane dhe numri i kateve	
• Koncepti peisazhor	
• Trafiku	
3.0 SKENARET	12
• Analiza e përparsive dhe mangësive	
4.0 KONCEPTI	14
• Premisat për concept	
• Identifikimi i problemeve	
• Komponentet bazë të lokacionit	
5.0 PROPOZIMI	17

PJESA GRAFIKE

SKENARI I	26
SKENARI II	27
SKENARI III	28
SKENARI IV	29
KONCEPTI	30
LOKACIONI DHE RRJETI RRUGOR	31
DESTINIMI I SIPËRFAQEVE DHE OBJEKTEVE	32
LËVIZJET E KËMBËSORËVE	33
DINAMIKA E LOKACIONIT	34
DENDËSIA E GJELBRIMIT DHE FUNKSIONI	34
SHESHET	35
NDRIÇIMI	36
AMBIENTI I NDËRTUAR	37
ZGJIDHJA IDEORE	38
TRAFIKU	39
DETALI I SHESHIT "NËNA TEREZË"	40
DETALE TË HAPËSIRAVE TË LIRA	41
PAMJE TË LOKACIONIT	42
NDARJA E NGASTRAVE	43



1.0 VIZIONI

QENDËR UNIVERSITARE POLIFUNKSION- ALE ME PËRMBAJTJE KOMPLEMENTARE AKTIVE GJATË TËRË DITËS QENDËR UNIVERSITARE QË PARAQET VATËR TË ARSIMIT DHE KULTURËS

- Qendra universitare, një koleksion i ndërtesave të vendosura përgjatë shtigjeve të këmbësorëve.
- Rrjetë e formësuar nga korridoret ekzistuese.
- Rrjetë që e definojnë hapësirën dhe e kontrollon atë.
- Ndërtesa që komunikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me shfrytëzuesit e të gjitha kategorive

SYNIMET SPECIFIKE TË PROJEKTIT

Rregullimi i hapësirës të qendrës së qytetit


- Transformimi i gjendjes së tanishme e cila shquhet me parregullsi dhe degradim të ambientit të ndërtuar.
- Krijimi i hapësirave publike të lira nga trafiku automobilistik
- Krijimi i hapësirave me përmbajtje mikse aktive të cilat do ta bënin lokacionin të shfrytëzohet gjatë tërë ditës dhe çdo ditë të javës.

Rregullimi i Qendrës Universitare

- Plotësimi me përmbajtje të nevojshme për fakultetet e reja/të vjetra - Artet, Mediat, Edukimi, Psikologjia,...
- Përmbajtje publike të kulturës dhe arsimit, sportit, hotelierisë dhe administratës së universitetit.
- Sigurimi i një hapësire të gjelbruar për të gjithë, një park universitar për të gjithë banorët e Prishtinës.

MJETET GJATË HULUMTIMIT NË TERREN

- VIZIONI PËR QENDRËN UNIVERSTARE-mendimi nga studentët e UP-së
- UNIVERSITETI, TREG I DIJES – punëtori me studenttë të UP-së



TAKIM PUNE ME UNIVERSITETIN E PRISHTINËS, MINISTRINË PËR ARSIM, SHKENCË DHE TEKNOLOGJI, BIBLIOTEKËN KOMBËTARE UNIVERSITARE, GALERINË E ARTEVE, INSTITUTIN ALBANOLOGJIK




Qëllimi i këtij takimi ishte prezentimi i problemeve ekzistuese, nevojave dhe kërkesave si dhe vizionin se si dëshirojnë ta shohin Qendrën Universitare këto institucione në të ardhmen.

Çështjet e dalura nga problemet e evidentuara gjatë fazës hulumtuese:

- Qendra universitare – përmbajtjet e reja sipas kërkesave ?
- Dikur e rëndësishme për tërë Kosovën
- Ende e ka atë rol?
- Biblioteka kombëtare universitare, instituti albanologjik dhe i historisë ende e ka atë rol?
- A do ta këtë edhe më tutje në bazë të reformimeve të cilat po ndodhin në arsimin e lartë?
- A do të vie deri te ndarja e Universitetit të Prishtinës në dy apo më shumë universitete?
- A është e drejtë që toka e komunës t'i dedikohet vetëm një universiteti, nëse arsimi konsiderohet veprimtari publike?
- A duhet zhvillimi i ardhshëm të nënkuptojë laramani të përmbajtjeve apo duhet të përmbajë vetëm arsimin e lartë dhe kulturën?

FAKULTETET:

- A është lokacioni i përshtatshëm për fakultetin?
- A janë hapësirat e mjaftueshme?
- A është organizimi i përshtatshëm për zhvillimin e mësimit?
- A ka laboratore dhe punëtori të pajisura me mjete të mjaftueshme?



Diskutimit i parapriu një prezentim i hulumtimit të gjendjes ekzistuese i bërë përmes pyetësorëve nëpër Institucione si dhe hulumtimi i ambientit të ndërtuar dhe hapësirave publike në kuadër të Qendrës Universitare.

REZULTATET NGA TAKIMI:


- Universiteti - një kampus modern
- Ndërtimi i serviseve universitare (ndërtesa për punë praktike, logjistikë, parkingje dhe hapësira të gjelbëruara
- Shqyrtimi i çështjes së kishës ortodokse në zonën e qendrës universitare (heqja e saj apo ndërimi i destinimit)
- Biblioteka, ndarja e saj në bibliotekë kombëtare dhe universitare si dhe dhe plotësimi i hapësirave për mësim
- Fokusimi i problematikës së universitetit jo vetëm në këtë zonë por edhe më gjërë.



Qendra universitare-1964

Qendra universitare-1974

Qendra universitare-2005



EKSPERIMENTI ME PANO PARA BIBLIOTEKËS

'SI DËSHIRONI TË JETË QENDRA UNIVERSITARE?'

Ndër mjetet e përdorura për hulumtime në terren ishte edhe anketimi me studentë, eksperiment ky ku studentët jepnin mendimet e tyre lidhur me qendrën universitare në mënyrë të shkruar. Mjeti- një lloj pyetësoi i formatit A0, përfshintë pyetjet :



- Si dëshironi të jetë qendra Universitare?
- Qendër për të gjithë apo vetëm për studentë?
- Qendër që shfrytëzohet 5 ditë në javë vetëm gjatë ditës apo që shfrytëzohet gjatë tërë javës edhe në mbrëmje?
- Cilat janë përmbajtjet që do t'a pasuronin këtë qendër Universitare?
- Si ta bëjmë këtë ambient më atraktiv?
- Çka mendoni për kishën ortodokse?


Anketa u bë 3 ditë rresht, në platonë e bibliotekës me mjete të ekspozuara në 4 pano, ku studentë të fakulteteve të ndryshme jepnin mendimet e tyre.

REZULTATI NGA EKSPERIMENTI

Ndër kërkesat e evidentuara gjatë përfundimit të këtij ekperimenti radhiten:

- Ndërtimi i objekteve të reja si: qendër banimi për studentë, fakulteti i Arteve, qendër interneti, shtëpi e kulturës, diskotekë, sallë sportive, pishinë, institucion që merret me edukatë dhe kulturë, xhami, lokale-kafeteri, parkingje etj (22% nga përqindja e gjithmbarshme)
- Rregullimi i ambientit ekzistues -20 %, prej së cilës 10% kanë kërkuar rregullimin e gjelbrimit, 7% rregullimin e shtigjeve (sidomos të shtegut që lidh





Bibliotekën Kombëtare Universitare me Fakultetin Juridik) dhe 3% kanë potencuar vendosjen e trupave ndriçues.

- Definimi i mënyrës së shfrytëzimit të qendrës universitare 20%, ku 11% kanë konsideruar se qendra universitare duhet të jetë vetëm për studentë, ndërsa 9% qendër që shfrytëzohet nga të gjithë.
- Diskutimi i çështjes së kishës ortodokse 17% prej së cilës 10% kanë konsideruar se kisha duhet të largohet nga lokacioni (duke konsideruar se objekti e dëmton imazhin e destinimit të lokacionit - qendër universitare, dhe të tjerat kanë të bëjnë me çështje religjioze) dhe 7% kanë konsideruar se që kishës ti jipët një destinim tjetër si: bibliotekë, Fakulteti i Arteve, local për argëtimin e studentëve, etj.
- Krijimi i hapësirave shtesë për lexim 8%- sidomos hapësira në kuadër të fakulteteve.
- Të tjera 13%



SI DËSHIRONI TË JETË QENDRA UNIVERSITARE?

- > QENDËR PËR TË GJITHË APO VETËM PËR STUDENTË ?
- > QENDËR QË SHFRYTËZOHET 5 DITË NË JAVË VETËM GJATË DITËS APO QË SHFRYTËZOHET GJATË TËRË JAVËS EDHE NË MBRËMJE ?
- > CILAT JANË PËRMBAJTJET QË DO TA PASURONIN KËTË QENDËR "UNIVERSITARE" ?
- > SI TA BËJMË KËTË AMBIENT MË ATRAKTIV ?
- > ÇKA MENDONI PËR KISHËN ORTODOKSE ?




CILI ËSHTË VIZIONI JUAJ































KUVENDI I KOMUNËS - PRISHTINË
DREJTORIA PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE NDËRTIM

urban







2.0 'QENDRA 2' SIPAS PLANIT STRATEGJIK

PLANI ZHVILLIMOR HAPËSINOR

	Boshti i qytetit city backbone
	Qyteti i vjetër old town
	Zonat mikse urbane: biznes dhe banim i dendur urban mixed zone: buisness and densed residential use
	Zona mikse urbane: destini rezidencial dhe ekonomik suburban mixed zone: commercial and residential use
	Kryesisht banim mainly urban residential
	Zonat ekonomike commercial zone
	Zonat industriale industrial zone
	Zonat e fshatit village zone
	Pylli / Pylli i qytetit të Prishtinës forest / Prishtinë City forest
	Hapësirat e hapura open spaces
	Kufijtë e zonave të ndërtuara border for built-up area
	Autostrada motorway
	Unaza e jashtme outer ringroad
	Unaza e mbrendshme inner ring
	Unaza qendrore central ring
	Rrugët tjera kryesore other main road
	Treni urban / aeroport tren lokal light rail / airport shuttle
	Kalim për këmbësorë walkway
	Vija e furnizimit me energj. Elektrike powerline
	Lumi / liqeni river / lake
	Hyrja në qytet city entrance
	Administrata / Residencia presidenciale administration / Presidents Residence
	Universiteti university
	Teatri, opera / institucionet tjera kulturore Theatre, opera / other cultural instution
	Klinika universitare University Clinic
	Stadioni/Arenat sportive stadium/sportsarena
	Rekreacioni / marinë recreation / marina
	Stacioni i trenit / stacioni i autobusëve railway station / busstation
	Tregu me shumicë/ mbledhja e ujërave wholesale market / sewage plant



	Etazhite	Indeksi i sip. të zhvillimit Banimi / yonat mikse	Industria / Ekonomia	Indeksi i hapsirës në m ²
	I-IV	0,2-0,3	0,6	max 0,8
	II-VI	0,3-0,4	0,8	max 1,2
	III-VIII	0,4-0,6		max 2,0
	IV-	0,6-0,8		max 3,0

Definicioni për “etazhë të plotë”



“Etazhë e plotë” është etazha, përdhësa e së cilës është jo më pak se 1,4 m mbi sipërfaqen e tokës dhe e cila ka në min. 2/3 e sipërfaqës së dyshemesë, lartësi të pastër prej min. 2,3m. Atika dhe etazhet mbi përdhësë si psh. nënkulmet, janë etazhe të plota nëse lartësia e pastër e sipërshenuar mbulon së paku 2/3 e etazhes përfundi kësaj. Sipërfaqeja e dyshemesë në etazhet që nuk janë “etazhet e plota” nuk do të konsiderohen ISD.

Definicioni i indeksit të shfrytëzueshmërisë së parcelës (ISHP)

Indeksi i shfrytëzueshmërisë së parcelës përcakton raportin në mes të parcelës dhe të ndërtimit që bëhet në të. Vlera numerike e ISHP është 1, nëse e tërë parcela është e mbuluar me ndërtim.



Definicioni i indeksit për sipërfaqe të dyshemesë (ISD)

Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë përcakton se sa metra katror e sipërfaqes së dyshemesë lejohet për m katror të parcelës. Sipërfaqja e tërësishme e dyshemesë kalkulohet me gabaritin e etazheve të plota të ndërtesës.















KONCEPTI PEISAZHOR

-  **Brezi i gjelbërt i qytetit**
Green City Belt
-  **Bulevardet dhe avenytë kryesore ndërlidhin hapësirë gjelbërta**
Main Boulevards and Avenues-Connecting Green Spaces
-  **Parqet e lagjeve**
'Neighbourhood' Parks
-  **Kabllimi**
Funicular
-  **Parqet peizazhore**
Landscape Park
-  **Qarku i rekreimit/parku peizazhor rural**
Recreation Circle/Agricultural Landscape Park
-  **Rruga**
Road
-  **Hekurudha**
Railway



TRAFIKU

	Autostrada Motorway
	Unaza e jashtme, 6/4/2 traka Outer Ringroad, 6/4/2 Lanes
	Unaza e mbrendshme, 4/2 traka Inner Ringroad, 4/2 Lanes
	Unaza qendrore Central Ringroad
	Rrugë tjera regjionale, 4/2 traka Other Main Through Road, 4/2 Lanes
	Rrugë tjera kryesore, 4/2 traka Other Main Road, 4/2 Lanes
	Transporti publik/ shuttle aeroport Commuter Train / Airport Shuttle
	Rrugë për këmbësorë Footpath
	Zona të ndërtuara Built-up Areas
	lumi/ liqeni River / Lake



3.0 SKENARET

ANALIZA E PËRPARËSIVE DHE MANGËSIVE

(shih Skenaret 1, 2, 3, dhe 4 në pjesën grafike, faqe 26,27,28,29)

SKENARI 1	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none">• zona e lirë për këmbësorë• krijimi i një zone të urbanizuar afaristo banimore• ntegrimi i zonës në qendrën e qytetit me përmbajtje që shfrytëzohet nga gjithë banorët e të gjitha moshave• galeria e arteve me funksionet përcjellëse e bën lokacionin më dinamik• krijimi i hapësiravë për vendparkim nëntokësor dhe lirimi i hapësirës mbi tokësore për këmbësor	<ul style="list-style-type: none">• ndërtimi i katedrales shton kërkesat për ndërtimin e objekteve religjioze muslimane në qendrën e qytetit• lokacioni i pamjaftueshëm për ndërtimin e një katedraleje• pozita e katedrales në portën e qendrës së qytetit në kundërshtim me karakterin e qendrës dhe vet qytetit• lokacioni i shkollës i pamjaftueshëm dhe në pamundësi fitimi
SKENARI 2	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none">• zona e gjelbruar si portë e qendrës• koncentrimi i përmbajtjeve tregtare nëntokësore• krijimi i hapësiravë për vendparkim nëntokësor dhe lirimi i hapësirës mbi tokësore për këmbësor	<ul style="list-style-type: none">• ruga automobilistike pengesë për këmbësorë (ndotja, zhurma, ndërprerja e lëvizjes,..)• lokacioni i shkollës i pamjaftueshëm dhe në pamundësi fitimi• lokacioni si qendër universitare i pamjaftueshëm dhe i papërshtatshëm sa i përket pozitës (për disa fakultete)• humbja e karakterit të zonës me përmbajtje jasht univrsitare (RTK, inst,...)• hfrytëzimi i lokacionit me prioritet për studentë



Nga katër skenaret e propozuara, në bazë të SWOT analizës skenari 1 është më i arsyeshëm të aplikohet sipas të cilit përbushen kërkesat nga fusha të ndryshme.

SKENARI 3	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • zona e lirë për këmbësorë • krijimi i një zone të urbanizuar afaristobanimore • pasurimi i hapësirës me përmbajtje kulturore • dislococimi i shkollës dhe i çerdhes në një lokacion më të madh me më shumë përmbajtje dhe mundësia e investimeve fitimprurësë në këtë lokacion • krijimi i hapësiravë për vendparkim nëntokësor dhe lirimi i hapësirës mbitokësore për këmbësor 	<ul style="list-style-type: none"> • humbja e karakterit të zonës me përmbajtje jashtë univrsitare (RTK, inst,...) • shfrytëzimi i lokacionit me prioritet për studentë
SKENARI 4	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • integrimi i zonës në qendrën e qytetit me përmbajtje që shfrytëzohet nga gjithë banorët e të gjitha moshave • largimi i përmbajtjeve (FSHMN, fakulteti i kultures fizike,..) liron hapësirat brenda dhe jashtë objekteve • krijimi i hapësiravë për vendparkim nëntokësor dhe lirimi i hapësirës mbitokësore për këmbësor 	<ul style="list-style-type: none"> • ndërtimi i katedrales shton kërkesat për ndërtimin e objekteve religjioze muslimane në qendrën e qytetit • lokacioni i pamjaftueshëm për ndërtimin e një katedraleje • pozita e katedrales në portën e qendrës së qytetit në kundërshtim me karakterin e qendrës dhe vet qytetit



4.0 KONCEPTI

PREMISAT E KONCEPTIT


- Zgjedhja e komponenteve bazë të lokacionit
- Kombinimi i komponenteve
- Marrëdhënja e komponenteve mes veti

IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE


- Variacionet e problemeve
- Analiza e përparësive dhe mangësive të variacioneve
- Zgjedhja e variacionit më të mirë

QENDRA 2– LOKACION HOMOGENJ APO HETEROGENJ ?

Lokacioni homogjen është më pak i shfrytëzueshëm për dallim nga ai heterogjen i cili karakterizohet me shumëllojshmëri aktivitete të cilat e bëjnë lokacionin më atraktiv dhe më mikpritës për qytetarët. Lokacioni 'Qendra 2' tenton të jetë një lokacion i tillë.



LOKACION HOMOGENJ



LOKACION HETEROGENJ

KOMPONENTET BAZË TË LOKACIONIT

Tri komponentet bazë të lokacionit:


1. Universiteti
2. Hapësirë e lire (Gjimnazi "Xhevdet Doda")
3. Banimi dhe afarizmi

UNIVERSITETI:

- a. Qendër universitare me përmbajtje kryesisht universitare
- b. Qendër universitare e pasuruar me përmbajtje tjera


LOKACIONI I SKOLLËS "XHEVDET DODA"

- a. Ndërtesë multifunksionale kulturore
- b. Oazë e gjelbëruar e qytetit
- c. Katedrale



ANALIZA E PËRPARSIVË DHE MANGËSIVE

UNIVERSITETI	
a. QENDËR UNIVERSITARE ME PËRMBAJTJE KRYESISHT UNIVERSITARE	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja e karakterit të qendrës universitare • Lehtësia e zgjerimit të përmbajtjeve universitare në pronësi universitare. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kufizimi i përfshirjes së disa përmbajtjeve tjera të nevojshme për qendrën e qytetit.
UNIVERSITETI	
b. QENDËR UNIVERSITARE E PASURUAR ME PËRMBAJTJE TJERA	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Pasurimi me përmbajtje të nevojshme për qendrën e qytetit (të cilat përmbajtje mund të jenë profitabile), • Lokacion më i frekuentuar qka do ta bënte lokacionin më të gjallë . 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndrimi i karakterit të lokacionit



LOKACIONI I SHKOLLËS "XHEVDET DODA"

LOKACIONI I SHKOLLËS "XHEVDET DODA"

a. NDËRTESE SHUMËFUNKSIONALE KULTURORE

PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> Plotësimi i kerkesave aktuale për një përmbatje te tillë Pozita e pershtatshme sa i përket vizitorëve Plotësimi i karakterit kulturor-arsimor i qendrës së qytetit 	

LOKACIONI I SHKOLLËS "XHEVDET DODA"

b. OAZË E GJELBRUAR

PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> Rritja e sipërfaqes së gjelbruar në qendër Një portë atraktive e qendrës së qytetit 	

LOKACIONI I SHKOLLËS "XHEVDET DODA"

c. KATEDRALE

PËRPARËSITË	MANGËSITË
	<ul style="list-style-type: none"> Destinimi orienton shfrytëzimin të kufizuar nga një grupim i caktuar i shoqërisë Identifikimi i qendrës së qytetit si qendër Religjioze, Inicimi i ndërtimeve të reja (objekteve të religjioneve tjera) në qendër të qytetit.



5.0 PROPOZIMI

Zgjidhja e propozuar për lokacionin 'QENDRA 2' tenton t'i përmbushë kërkesat e të gjithë pjesëmarrësve të involvuar në proces:

- Shfrytëzuesit e hapësirës - banorët, studentët dhe mësimdhënësit e tyre, pronarë dhe ndërmarrës të përmbajtjeve afariste si dhe shfrytëzues të ndryshëm të cilët frekuentojnë në lokacion.
- Institucionet të cilat ndodhen në lokacion - Universiteti, Biblioteka Popullore Universitare, Galeria e Arteve, Institutet, Pallati i Radios.
- Komuna e Prishtinës si pronar i tokës dhe menaxhues i hapësirave publike.

Qendra Universitare me sipërfaqen e vet dhe përmbajtjet në lokacion ka rol dominant në krahasim me pjesën tjetër të lokacionit. Ky fakt dikton që zgjidhja e propozuar t'i nënshtrohet një kërkesë e cila nuk është lehtë të plotësohet: krijimi i një hapësire unike e cila në të njëjtën kohë e bën distinkcionin e Qendrës Universitare si tërësi dhe mundëson një lidhje organike në mes të zonave të ndryshme të lokacionit. Kërkimi i elementeve hapësinore të cilat do të mundësonin këtë lidhje ka qenë në qendër të konceptit të idesë.

Elementet hapësinore janë kërkuar në bazë të dy premisave kryesore:


- Lokacioni 'QENDRA 2' duhet të jetë një hapësirë me përmbajtje heterogjene.
- Qendra Universitare si përmbajtje kryesore nuk do të duhej të jetë e tipit të "kampusit klasik", por duhet të jetë e hapur duke ofruar mundësi arsimimi dhe edukimi për të gjithë të interesuarit, pa dallim moshe, gjinie dhe etniteti.

Janë dy elemente hapësinore të cilat e mundësojnë këtë lidhje organike: Sheshi para Katedrales Katolike të propozuar dhe Parku i Universitetit (shih pjesën grafike f 38) që kanë rrolin lidhës të përmbajtjeve të ndryshme duke formuar një kontinuitet të sekuencave të hapësirave publike dhe ndërtesave me përmbajtje të cilat komunikojnë në mënyrë të ndryshme me shfrytëzuesit. Meqenëse Komuna ka aprovuar kërkesën e Kishës katolike për ndërtimin e Katedrales në lokacionin ku tash ndodhet Gjimnazi Xhevdet Doda, kjo ka imponuar që Katedrala të merr një rol të focit orientues i cili do të dominojë me elemente arkitektonike vertikale.

STRUKTURA URBANE

Struktura urbane e ka bazën në zhvillimet e mëhershme në lokacion. Me këtë plan rregullues i cili ka karakterin e transformimit, struktura aktuale urbane mbetet afërsisht e njëjtë sa i përket dendësisë, kurse ajo që ndërron është në indeksin e sipërfaqes së ndërtuar, meqenëse, në disa pjesë të lokacionit, parashifet rritje e etazhitetit, por e cila nuk i kalon udhëzimet nga plani strategjik. Hapësira publike zgjerohet, rritet numri përmbajtjeve.

Koncepti e vendosë njeriun në qendër të ngjarjes, kurse trafiku automobilistik mbetet në kufinj të lokacionit dhe nëntokë, kurse parkimi përveç në periferi dhe në disa pika, kryesisht është nën tokë.



Qendra Universitare shquhet me një vendosje ortogonale të ndërtesave dhe ky faksimil urban është shfrytëzuar për të përcaktuar edhe vendosjen e përmbajtjeve të reja të cilat do të vendosen në qendër. Pjesa tjetër e lokacionit i referohet zhvillimit të ngjarjes në bazë të përmbajtjeve të sotshme, por me një transformim të rrugës "Perandori Justinian", në rrugë me dendësi më të madhe ndërtimore dhe përmbajtje tregtare dhe shërbyese më atraktive dhe mundësi pranimi të një numri më të madh të shfrytëzuese. Ky drejtim i qarkullimit lidhet me pozitën e Stacionit të autobusëve dhe Lagjet Dardania dhe Lakrishte. Këtu karakteri i rrugës së kombinuar afariste dhe banimore është ruajtur dhe përparohet me ndërtesat e reja dhe hapësirën publike të planifikuar.

PËRMBAJTJET

BANIMI

Banimi në qendër të qytetit është i volitshëm për shkak se ai e bën më dinamik lokacionin gjatë tërë ditës dhe çdo ditë gjatë javës. Është vërtetuar se kur në qendër ka edhe banim, hapësirat janë më të sigurta për shkak të frekuencës së madhe të qarkullimit të njerëzve.

Aktualisht në lokacion janë 100 njësi banimi me afërsisht 460 banorë.


Banesat ekzistuese nuk ofrojnë kushte kualitative të banimit si në pikëpamje të hapësirës banimore, poashtu edhe sa i përket hapësirave përcjellëse (mungesa e parkimit, hapësirës për lojë dhe pushim). Me propozim parashifet rrënimi i dyqaneve të përkohshme dhe ndërtimi i një kompleksi të ndërtesave të kombinuara afariste-banimore. Ky propozim parshif rritjen e numrit të njësisve banimore me sipërfaqe më të mëdha të banesës dhe përmbajtje përcjellëse të cilat e rrisin kualitetin e banimit. Janë gjithsej 235 banesa me sipërfaqe mesatare prej 85 m².

AFARIZMI

Zonat qendrore të qytetit nuk mund të paramendohen pa funksione afariste. Rruga "Perandori Justinian", gjatë një periudhe të gjatë kohore ka krijuar imazhin e njëres prej hapësirave më frekuentuese të qytetit të Prishtinës. Edhe pse shumica e dyqaneve tregtare janë të karakterit të përkohshëm, me kualitet jo të kënaqshëm të hapësirave, interaksioni në mes të hapësirës publike dhe private këtu është shumë intensiv. Transformimi dhe zgjerimi i përmbajtjeve afariste, do të sigurojë një kualitet të ri të jetës publike në qendër të qytetit. Vija e dyqaneve në rrugën Perandori Justinian, për të krijuar një kontinuitet të pandërprerë të qarkullimit përmes nënkalimit të Bulevardit Bill Clinton do të lidhet me aksin e lëvizjes në drejtim të Lagjeve Dardania dhe Lakrishte. Për të arritur këtë, ndërtesat përdhese të cilat janë ndërtuar në vitet '90 pa ndonjë lidhje me planin urbanistik të lagjes Dardania do të duhej rrënuar.

ARSIMI FILLOR DHE I MESËM

Shkolla fillore Faik Konica pasurohet me përmbajtje sportive të cilat i mungojnë – sallën e edukatës fizike e cila do të vendoset pjesërisht nën tokë si dhe terrenet e hapura me tribuna për shikues. (shih pjesën grafike f.38)



Për shkak të vendimit të Kuvendit të Komunës për Katedralen, gjimnazi Xhevdet Doda do të shpërngulet nga lokacioni i qendrës në afërsi të pallatit të shtypit.

ARSIMI I LARTË

Pjesa më e madhe e lokacionit i takon Qendrës Universitare në të cilën ndodhen disa fakultete të Universitetit të Prishtinës, Biblioteka, Galeria e Arteve, Instituti Albanologjik dhe i Historisë, si dhe një hapësirë e madhe e lirë pjesërisht e rregulluar.

Megjithse në vitet 70 është hartuar një Plan Detal Urbanistik për Qendrën Univesitare nga Prof. Bashkim Fehmiu, ai plan nuk është aprovuar asnjëherë. Disa vendime për ndërtesat ekzistuese janë marrë në bazë të atij plani. Për shkak të ndryshimeve në sistemin e shkollimit të lartë, Reformave sipas Kartës së Bolonjës, themelimit të universiteteve private, kërkesat për plan rregullues të qendrës kanë ndryshuar.

Në vitin 1991 një pjesë e lokacionit të qendrës i është dhënë kishës orthodokse serbe nga regjimi i atëhershëm serb, për të ndërtuar kishën e re. Kjo ka vështirësuar kushtet për të gjetur një zgjidhje të mirëfilltë.

Autorët janë udhëzuar që për shkak të ndjeshmërisë politike, ky lokacion mos të trajtohet me këtë plan rregullues.

- Disa çështje të artikuluar më herët mund të konsiderohen si premisa prej të cilave është krijuar vizioni për Qendrën Universitare.


- Dikur e rëndësishme për tërë Kosovën, ende e ka atë rëndësi!?
- A do ta këtë edhe më tutje në bazë të reformimeve të cilat po ndodhin në arsimin e lartë?
- A do të vie deri ndarja e UP-së në dy (më shumë universitete)
- A është e drejtë që toka e komunës t'i dedikohet vetëm një universiteti- nëse arsimi konsiderohet veprimtari publike?
- A do të mbetet galeria e arteve të kosovës në lokacion?
- A duhet zhvillimi i i ardhshëm të nënkuptojë laramani të përmbajtjeve apo duhet të përmbajë vetëm arsimin e lartë dhe kulturën
- Biblioteka Kombëtare, Instituti Albanologjik dhe i Historisë, a e kanë ende rëndësinë iniciale?

Për t'i dhënë përgjegje këtyre çështjeve përmes planit rregullues, është konsideruar esenciale që në rradhë të parë të parashifen përmbajtje të cilat janë universale, kurse hapësirat e reja mësimore të jenë fleksibile dhe të mundësojnë adaptimin ndaj kërkesave për arsimim universitar, të cilat në të ardhmen do të jenë shumë dinamike.

Për t'i plotësuar kërkesat për hapësirë të fakulteteve të cilat aktualisht janë të shpërndara nëpër ndërtesa të ndryshme jofunktionale për mbarëvajtjen e mësimimit. Këtu janë përfshirë Fakulteti i Arteve, Edukimit dhe Psikologjisë.

Amfiteatrot para fakultetit Juridik-Ekonomik janë paraprë të rrënohen dhe të njëjtit të ndërtohen nën tokë, për të mundësuar krijimin e një sheshi ku studentët mund të tubohen dhe të kalojnë kohën e lirë në mes të mësimimit.

Lidhur me ndërtesën e radios është paraparë zgjerimi për Fakultetin e mediave, një lëmi e cila është në ngritje e sipër. (shih pjesën garfike f.38)



Krahu i Fakultetit të Shkencave Matematiko natyrore i cili është shumë afër rrugës Eqrem Cabej (e cila sipas planit strategjik i nevojitet zgjerimi) duhet të rrenohet pasi që nuk ofron kushte optimale për zhvillimin e mësimin, afërsia e rrugës dhe zhurma nga trafiku. Kjo edhe nga shkakun e kërkesës që FSHMN të transferohet jashtë qytetit për të siguruar laboratore të nevojshme të cilat nuk mund të vendosen në lokacionin e tashëm.

Poashtu është paraparë një ndërtesë qendrore multifunkionale e Universitetit me administratën dhe Qendrën e Studentëve, restorantin e studentëve dhe sallën universale dhe hapësirën për ekspozita. Ndërtesa ekzistuese e Rektoratit i dedikohet Muzeut të Univesitetit të Prishtinës.

Për zhvillimin e aktiviteteve sportive të studentëve parashifet transformimi i ndërtesës së tashme të FKF. Ndërtesa do të zgjerohet në objekt të kombinuar sportiv-sallë e sportive të vogla dhe pishinë e mbyllur. Ndërtesa shoqërohet edhe me terrene sportive të hapura.

Në ndërtim e sipër është Insitutit i Historisë, i cili me vendosjen e vet nuk e ka rrespektuar konceptin ortogonal të zhvillimit të Qendrës Universitare. Kjo posacërisht ka të bëjë me këndin e lokacionit, i cili fare nuk është trajtuar.

KULTURA

Biblioteka Kombëtare e cila paraqet një pikë fokale në lokacion, nuk pëson ndryshime përvec kërkesë për hapje të përdhësës - kafeneja e cila duhet të ofrojë një komunikim me kaluesit. Përkundër kërkesës së madhe për vende të leximit, ndërtesa nuk lejon mundësi të zgjerimit. Për këtë qëllim ndërtesat e reja për fakultete duhet të përfshijnë bibliotekën me hapësira më të mëdha të leximit.


Galeria e Arteve të Kosovës është paraprë të shpërngulet në një lokacion tjetër, kurse në vend të saj është paraparë të jetë Fakulteti i Arteve Vizuale, në kuadër të të cilit janë Qendra e Arteve dhe Biblioteka multimediale. Këto përmbajtje e bëjnë fakultetin e arteve të hapur dhe aktiv gjatë tërë ditës dhe javës.

Pallati i Radios, për të plotësuar kërkesat gjithnjë e më të mëdha të mediave, duhet të rimodelohet në një ndërtesë me hapësira më fleksibile që mundësojnë zhvillimin e mediave të ndryshme në rritje. Këtë e përkrahë edhe krijimi i Fakultetit të Mediave në kuadër të zgjerimit të ndërtesës.

HAPËSIRA PUBLIKE

Meqenëse është fjala për qendrën e qytetit, hapësira pulike është në qendër të konceptit të zgjidhjes. Sigurimi i një kualiteti të lartë të hapësirës publike është synim i zgjidhjes së ofruar. Hapësirat ekzistuese publike, megjithse të frekentuara nga një numër i madh shfrytëzuesish, megjithate nuk plotësojnë kriteret e nevojshme për një lokacion të tillë. Hapësirat publike janë të shkallëzuara në bazë të rëndësisë dhe ato janë kryesisht të tipit të hapur dhe pjesëridht gjysëm të hapur. Në bazë të llojit, ato janë në formë të:

- sheshit
- rrugëve të këmbësorëve dhe
- gjelbrimit




Sheshet, në bazë të llojit dhe funksionit të vet krijojnë hierarkinë e përmbajtjeve të cilave ato u përkasin. Për shkak të konceptit ortogonal të vendosjes së përmbajtjeve, lidhjet janë të qarta dhe të kalueshme në të gjitha drejtimet.

Ndarja tyre është edhe sipas funksionit. (Shih pjesën grafike f.35).

Sheshi 'Nënë Terezë' para katedrales paraqet përfundimin e bulevardit 'Nënë Tereza', dhe pikën ku kryqëzohen vijat e lëvizjes në drejtim të Bibliotekës Kombëtare Universitare, dhe në drejtim të lagjeve Dardania dhe Lakrishte përmes rrugës Perandori Justinian.

Me të lidhet pjesa e gjelbrimit në kuadër të qendrës universitare e cila me pjerrësinë dhe përpunimin e vet dhe përbën edhe një lloj të amfiteatrit, kurse hapësira e sheshit paraqet një lloj skene për manifestime të ndryshme të cilat mund të ndodhin në këtë shesh. Sheshi "rrugë", gjegjësisht rruga 'Perandori Justinian', për një kohë të gjatë ka krijuar imazhin e një hapësire shumë intenzive publike, për shkak të numrit të madh të ldyqaneve dhe lokaleve hotelierike. Edhe pse kryesisht me objekte të karakterit ë përkohshëm, komunikimi intenziv në mes të hapësirës publike dhe hapësirës së mbyllur e bën këtë rrugë të jetë e gjallë gjatë tërë ditës dhe javës. Këtë karakteristikë, zgjidhja e re tenton ta pasurojë edhe më tej me ndërtimin



e hapësirave banesore dhe afariste të karakterit të përhershëm si dhe me shëndrrimin e rrugës në një hapësirë të lirë të dedikuar vëtëm për këmbësorë, e cila mundëson një interaksion edhe më të madh në mes të hapësirës publike dhe asaj private. Me kalimin nën bulevardin 'Bill Clinton', kjo arterie tenton krjojë lidhje të pandërprerë në drejtim të lagjes 'Dardania' dhe eliminon kalimin e tashëm nëpër këtë bulevard i cili paraqet rrezik permanent për këmbësorë.

Sheshet 'tranzite janë hapësira në të cilat përvec që njerëzit mbliidhen, ato janë edhe kryqëzime të drejtimeve të ndryshme të lëvizjes. Pra ato lidhin hapësira publike.

Këto sheshe ndodhen në hapësirën e brendshme të qendrës universitare.

Sheshet e pavarura, janë hapësirat para ndërtesave publike, por të cilat nuk kanë lidhje direkte me sheshet tjera.

Sheshet lidhëse, kryesht në kuadër të qendrës universitare, me hapësirën e vet lidhin dy apo më shumë përmbajtje të cilat janë njëra pranë tjetrës.

KORRIDORET DHE HYRJET- definojnë udhën ku njerëzit hyjnë dhe lëvizin në të, kurse hyrjet janë pikat - focit hapësirat publike të cilat e bëjnë të qartë hyrjen në lokacionin e qendrës. Korridoret në lokacionin i ndajmë në dy grupe:

- Korridoret kryesore - që lidhin lokacionin me pjesët përreth (korridori A perëndim - lindje lidh pjesën e aktashit me qytezën Pejton dhe korridori B veri-jug lidh pjesën e Ulpianës me qendrën)
- Korridoret sekondare- paraqesin lidhjet e brendshme. Më të theksuara janë ato që bëjnë lidhjen më sheshin "Nëna Terezë"

QARKULLIMI

Koncepti i propozuar trafikun automobilistik e eliminon nga lokacioni i qendrës. Ai kryesisht mbetet në periferi dhe nën tokë, me lidhje, të cilat do të duhej të realizohen në faza duke u zëvendësuar me hapësira për qarkullimin e këmbësorëve.

Trafiku automobilistik zhvillohet në rrugët rrethuese – unaza e qendrës, rruga Eqrem Cabej, kurse lidhja e unazës me rrugë tërthore është paraparë përmes nëntokës, që nga hoteli Grand të dilet pranë Fakultetit Ekonomik/Juridik. (Shih pjesën grafike f. 31).

Në disa pika janë paraparë qasje në lokacione të ndërtesave – te Instituti i Historisë, fakulteti i Arteve dhe fakulteti Ekonomik/Juridik, ndërtesa e Mediave. Poashtu në pjesën e poshtme të lokacionit kemi një qasje e cila është e lidhur edhe me garazhin qendror si dalje emergjente.

Edhe pse profilet e rrugës unazore janë të parapara për tri automjete në shirit, megjithatë, shpejtësia do të duhej kufizuar në jo më shumë se 50km/h.

Këmëbsorët janë në qendër të konceptit. Është tentuar që të ofrohen të gjitha mundësitë për këmëbsorët - ata që ecin shpejtë, ata të cilët dëshirojnë ta përjetojnë mjedsin e gjelbëruar dhe të ndërtuar ose ata të cilët ndalen në lokacion për ndonjë punë apo për të pushuar. Shumëllojshmëria e përmbajtjeve mundëson laramani edhe të mundësive, në çdo kohë dhe ditë/natë, javë, stinë etj. Për çdo grupmoshë, e që lokacionin e bën kualitativ për të gjithë.

PARKIMI

Si pjesë e trafikut, parkimi në qendër është gjithmonë një ndër problemet kryesore.

Kryesisht, propozimi e parashef parkimin në garazhe nëntokësore. Janë pesë garazhe nëntokësore me afërsisht 2000 vend-parkime, të cilat për komunën nuk paraqesin vetëm mundësi për zgjidhje të problemeve të parkimit, por edhe një mundësi të përfitimit nga taksat, duke konsideruar pronësinë e tokës në lokacion.

Garazhi i madh pranë fakultetit Filologjik/Filozofik, mund të ketë edhe përmbajtje tregtare, gjë që do të tërhiqte më lehtë investitorët e mundshëm. (Më gjersisht shih pjesën grafike f. 39)

GJELBRIMI

Hapësira e gjelbëruar përfshin sipërfaqen më të madhe në lokacion. Parku i Universitetit, skveret, dhe hapësirat tjera të gjelbëruara të hapura ose të mbyllura ndaj publikut, përbëjnë një faktorë të rëndësishëm jo vetëm për qendrën, por edhe për tërë qytetin, pasi hapësira të tilla në qendër të qytetit nuk ka. Kjo e shton vlerën publike të lokacionit dhe e bën atë tërheqës për të gjitha moshat.

Janë tri lloje trajtimit të sipërfaqeve të gjelbërta:


- Hapësirat me gjelbrim të lartë të dendur
- Hapësirat me gjelbrim të lartë jo të dendur
- Hapësirat pa gjelbrim të lartë (Më gjersisht shih pjesën grafike f. 34)

Kurse në bazë funksionit, gjelbrimi është:

- Izolues,
- Potencues
- Dekorues

Grupacione të ndryshme të gjelbrimit mund të kenë më shumë se një funksion.

Parku Universitar, me elementet përbërës paraqet një hapësirë të pasur pejsazhore në qendër të qytetit. Ai duhet t'u mundësojë qytetarëve kalimin e kohës së lirë, pushimin dhe argëtimin. Hapësira për ekspozime, posaçërisht të vlerave të artit publik, mundëson edhe ndryshimin e kohëpaskohshëm të imazhit të parkut varësisht prej asaj se çka ekspozohet.



REKOMANDIM

Për nga aspekti arkitektonik ky plan rregullohet tenton të siguron që secila ndërtesë e re të kontribuojë në vizionin e lokacionit.

Ekzistojnë 2 principe:

- Marrëdhënja funksionale mes ndërtesave ekzistuese dhe të reja (të planifikuara). Funksionaliteti kërkon që lokacioni në tërësi i përmbajtjeve të reja të determinohet nga shtytëzimi i tyre. Plani tenton të krijojë një zonë akademike të pasur me përmbajtje studentore. Një zonë me aktivitete të ndryshme dhe variacione të shfrytëzimit.

- Roli i ndërtesave të reja është të definojnë formësimin hapësinor. Kjo nevojë e drejton edhe pozitën e ndërtesave në hapësirë. Plani tenton që hapësirat ekzistuese dhe ato të propozuara të bëjnë formësimin struktural të qendrës universitare në të ardhmen. Të gjitha ndërtesat e reja duhen të kontribuojnë në këtë strukturë duke e qartësuar hapësirën.

MASA-vëllimi i ndërtesave përcakton aftësinë e strukturës në definimin e hapësirës dhe të kompatibilitetit hapësinor me strukturat fqinje. Ndërtesat e reja në qendrën universitare për nga masa do të jenë të njëjta me ato ekzistuese.

Ndërsa nga aspekti peisazhor caqet, kufizimet, theksimet dhe karakteri i hapësirës në lokacion janë të definuara përmes bashkëveprimit mes ndërtesave dhe masës së gjelbrimit si dhe shfrytëzimit të gjelbrimit të lartë. Duke e pasur dimensionin e tretë të lartësisë, këto elemente të dizajnit janë mëse të rëndësishme në organizimin hapësinor se sa elementet dy dimensionale si rrugët, shtigjet etj.

HAPËSIRAT E LIRA – plani përpikëqet të organizon një sistem të ri përmbledhës të hapësirave të lira duke i lidhur objektet mes veti. Vitaliteti i këtyre hapësirave qëndron në shumëllojshmërinë e nevojave të studentëve, mësimdhënësve dhe vizitorëve. Përpjekjet e ardhshme për të shtuar ose rritur këto hapësira duhet të shtojnë shumëllojshmërinë në shkallë, shfrytëzim dhe

E kjo paraqet një përparësi të parkut. Lulishtja prapa katedrales është menduar si vend ku mbillen lule të stinëve dhe nënqiellit të ndryshëm. Kjo mundëson që në bazë të ngjyrës së luleve ta njohim edhe kohën apo stinën në të cilën jemi.

Llojet e bimëve të propozuara:


- Bliri - TILIA TOMENTOSA
- Panja - ACER NEGUNDA
- Frashëri fletëngushtë - FRAXINUS AN-GUSTIFOLIA
- Krekëza fletëmadhe - ACER CAMPESTRE
- Bliri fletëgjërë - TILIA PLATIPHYLLOS
- Robinja - ROBINJA PSEUDOKACIA

NDRIÇIMI PUBLIK

Rëndësi e posaçme i është kushtuar ndriçimit të hapësirave publike në lokacion, në bazë të llojit përmbajtjeve dhe pozitës që ato kanë.

Llojet e ndriçimit të propozuar janë:

- Ndriçimi orientues
- Ndriçim reprezentativ
- Ndriçim joshës
- Ndriçim ftues



karakter si mënyrë e pasurimit të përjetimit të lokacionit.


Dy pikat kyqe të peizazhit:

- Të theksohet thjeshtësia e shprehjes, dukshmëria duhet të vazhdon në nivel të tokës dhe paterna e këmbësorëve duhet të krijohet ashtu që ti largohet krijimit të zonave të vdekura dhe të izoluara.
- Çdo ndërtesë të jetë e inkorporuar në një sistem qarkullues në mënyrë që këmbësorët të gjejnë qasjen në ndërtesë.



QENDRA 2

PLANI RREGULLUES ' QENDRA 2', PRISHTINË PJESA GRAFIKE



KUVENDI KOMUNAL I PRISHTINËS
DREJTORATI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT
DHE NDËRTIMTARISË

